



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 98, Datë 12.05.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS E SHOQËRISË
“SUNPRO” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË EOLIKE,
ME KAPACITET PRODHUES 3 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1648/1 prot., datë 08.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “SunPro” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648 prot., datë 30.04.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit nga centrali gjenerues i energjisë eolike, me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo

refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE si dhe ka kryer pagesën e aplikimit më 29.04.2025 sipas Aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a dhe d). Konkretisht, ai ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur elektronikisht nga QKB, më datë 23.04.2025.
- Në përputhje me pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c). Sipas gërmës “a” është depozituar vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, datë 23.04.2025, që konfirmon se shoqëria “SunPro” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera tatimore dhe të sigurimeve shoqërore/shëndetësore. Referuar Planin e Biznesit, financimi i projektit parashikohet të realizohet në vlerën 30% nga kapitali aksionar dhe 70% me kredi bankare nga banka te nivelit të dytë.
- Në përputhje me pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (e dhe f).
- Shoqëria rezulton se ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit, në përputhje me përcaktimet e Aneksit A të Rregullores.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 146, datë 13.03.2023, *“Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë, nga shoqëria “SunPro” sh.p.k.”*.
- Shoqëria është pajisur me Vendimin për VNM Paraprake, lëshuar më 18.02.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit *“Sistem gjenerues me erë, Maja e Shtogut dhe veprave ndihmëse”*.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë Dëshminë e Penalitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin e saj.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentin për strukturën e saj organizative të nënshkruar dhe vulosur.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë një dokument të përditësuar në lidhje me financimin nga banka, e po ashtu të dokumentojë mbështetjen financiare për pjesën e mbetur të investimit, prej 30%.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Shoqëria ka plotësuar pjesërisht Shtojcën 2, ku ka deklaruar si datë të fillimit të operimit vetëm vitin 2027. Në referencë me përcaktimet e VKM-së nr. 146, datë 13.03.2023, e cila parashikon afatin 36-mujor për vënien në punë të centralit, ky operim duhet të nisë brenda datës **13.03.2026**. Në këto kushte, vlerësohet që shoqërisë t'i kërkohet të bëjë përditësimin përkatës të këtij informacioni, në përputhje me VKM-në dhe, nëse është e aplikueshme, me ndonjë detyrim që rrjedh nga kontrata me MIE-n.
 - **gërma “b”**: Në funksion të koordinimit të jetëgjatësisë së deklaruar të centralit me afatin maksimal të licencës së përcaktuar në legjislacion (deri në 30 vjet), vlerësohet që shoqëria të depozitojë në ERE një dokument teknik që justifikon jetëgjatësinë e deklaruar të centralit eolik (p.sh. garanci teknike ose certifikatë e pajisjes). Gjithashtu, shoqëria duhet të informojë nëse ka krijuar një shoqëri për qëllime të veçanta, në përputhje me pikën g) të VKM-së nr. 146/2023, dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës në rast se ajo ekziston. Po ashtu, referuar pikës iii të VKM-së së sipërcituar, ku parashikohet lidhja e një kontrate me MIE-n për realizimin e projektit, shoqërisë i kërkohet të informojë nëse kontrata është lidhur dhe, nëse po, të depozitojë një kopje të saj në ERE.
 - **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/Marrëveshjen përkatëse të nënshkruar me OST sh.a.
- Shoqëria, duhet të depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e veprës.
 - Përveç sa më sipër, në referencë të një korrespondence të zhvilluar më herët me Autoritetin e Aviacionin Civil (AAC), në të cilën është theksuar nevoja që ky autoritet të informohet në rastet kur një subjekt aplikon pranë ERE për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike, me qëllim identifikimin dhe reflektimin e këtyre objekteve në hartat përkatëse për nevojat e navigimit ajror, vlerësohet e nevojshme që AAC të vihet në dijeni për fillimin e kësaj procedure licencimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë eolike, me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SunPro” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Aviacionit Civil për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI